



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të vazhdimit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30.10.2018 dhe 31.10.2018, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Visare Gashi (PSD), Uran Ismaili (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Sokol Berisha (AAK).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesuesi i Kuvendit.

### Pika e dytëmbledhjetë

**Informim mbi punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) dhe NPL "Hortikultura".**

Lidhur me punën e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB), të pranishmit i informoi Dren Kukaj, përfaqësuesi i ekzekutivit në Komisionin komunal të aksionarëve të NPB-së.

**Agim Gashi** tha se NPB nuk ka të bëjë me tregjet. Në Prishtinë ka qenë një ndërmarrje, e cila është quajtur Ndërmarrja e Tregut dhe do të ishte shumë më racionale dhe më e arsyeshme që Ndërmarrja e Tregut të rithemelohej, ose të përfundojë procedura e zhbërjes së asaj ndërmarrjeje, në mënyrë që ajo të marrë formën e vetë dhe kuptimin e vetë funksional brenda interesave të Komunës së Prishtinës.

**Egzon Azemi** kërkoi nga Zyra ligjore që të rishikohet votimi për shkarkimin e tij nga pozita e aksionarit, për shkak të konfliktit të interesit që z. Bashkim Beha, i cili është asamblist dhe i punësuar në atë ndërmarrje, e që e ka bërë kuorumin dhe ka votuar në atë seancë ku jam shkarkuar. Kjo edhe njëherë e vërteton se, në fakt qëllimi dhe kjo vërsulje e madhe e pushtetit ndaj NPB-së, duke i lënë kështu në harresë të gjitha ndërmarrjet tjera që janë buzë falimentimit, qëllimin e kishte vetëm partiak dhe kjo ndërmarrje sot e tutje do t'i shërbejë vetëm partisë së PSD-së, andaj kërkoi shkarkimin e dy anëtarëve aktual të Komisionit komunal të aksionarëve.

**Fiknete Bejta** tha se raporti është më shumë sipërfaqësor, sepse në përmbajtje nuk tregon realitetin në këtë ndërmarrje. Edhe nëse nuk e lexojmë raportin fare, vetëm nga ajo që shkruhet në media, mund të konstatojmë se në këtë ndërmarrje ka pasur probleme të mëdha. Nëse ka pasur probleme kaq të mëdha me Bordin, me menaxhmentin, me Komisionin e aksionarëve, si mund të ketë koordinim në planifikim dhe zhvillim të ndërmarrjes?! Në këtë raport po ashtu është potencuar se do të ketë 52 aktivitete të prokurimit, me mbi 533 mijë euro. Një raport kaq i mangët, si mund të quhet i suksesshëm, ose edhe raporti i auditimit nuk ka një kredibilitet. Auditori në fjalë nuk ka kredibilitet dhe aq shkelje ka parë, sa që nuk e ka nënshkruar, pastaj nuk e ka letrën e konfirmimit të raportit.

**Eman Rrahmani** tha se për këtë ndërmarrje, si dhe për të gjitha ndërmarrjet tjera, kisha kërkuar një auditim financiar dhe një auditim të performancës. Po ashtu, edhe në ndërmarrjen "Stacioni i Autobusëve" ka shumë keqpërdorime dhe ka keqmenaxhim. Ai propozoi që të hidhet në votim shkarkimi i dy aksionarëve që janë emëruar nga Kuvendi i Komunës në NPB, për shkak se ata që kanë konflikt interesi, nuk duhet të marrin pjesë në votim.

**Vlora Dumoshi** kërkoi të dijë se nga cili burim financiar do të merren paratë për ndërtimin e tregjeve dhe pse nga NPB-ja.

**Sami Boroci** lidhur me shqetësimet që u ngritën prej parafolësve, theksoi unë përkrah trajtimin në rrugën ligjore, në qoftë se z. Bashkim Beha është ngritur ligjshëm në pozitë ose jo, nëse është konflikt interesi, mendoj që ka organe të cilat e vlerësojnë këtë punë dhe nuk jemi ne ata që duhet me e vlerësuar.

**Bashkim Beha** theksoi se, për hir të informimit të drejtë, ju njoftoj se unë në NPB jam që nga viti 2015, në të njëjtën pozitë, as nuk jam ngritur, as nuk jam zbritur. Jam ushtrues

detyre i zyrtarit kryesor financiar për një periudhë të përkohshme. Në të vërtetë edhe ushtrues detyre qenka konflikt interesi, unë pa problem e lë pozitën, nuk jam i lidhur për atë pozitë, nuk është i lidhur kurrkush, tek e fundit e kemi një program politik, për të cilin jemi zotuar dhe do ta qojmë përpara.

**Leonora Shabani - Bajraktari** propozoi që të shkohet me votim për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit të aksionarëve.

**Migjen Shala** tha se zyrtari për interpretim nga Zyra ligjore nuk është adekuat dhe nuk ka nevojë më me marrë pjesë këtu, sepse nuk po na kthen përgjigje të duhura. Pra, kërkojmë të na japë interpretimin ligjor se a është konflikt interesi apo jo.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës dhe përfaqësues i ekzekutivit në Komisionin komunal të aksionarëve në NPB dhe Ardian Olluri, ish- shef i Zyrës ligjore, tani drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, dhanë sqarime të nevojshme.

Lidhur me propozimet për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve, kryesuesi kërkoi një interpretim ligjor nga Zyra ligjore.

**Fatos Dibra** theksoi se çdo plotësim dhe ndryshim i rendit të ditës bëhet në fillim, para se të miratohet rendi i ditës, sepse nuk mund të ndryshojë rendi i ditës në fund të mbledhjes. Sipas udhëzimit administrativ, thuhet se anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike para miratimit të rendit të ditës, gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është urgjente.

Kryesuesi konstatoi se mbledhja u ndërpre në orën 11:20, për shkak të kuorumit.

*Vazhdimi i mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës, më 31.10.2018.*

**Suzan Kika** i njoftoi të pranishmit, duke thënë se më 1 tetor 2018, kam dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banësore.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shkarkimin e Genc Sherifit, anëtar i Komisionit të aksionarëve të NPB-së.

Kryesuesi konstatoi se më 3 vota për, 23 kundër dhe 3 abstenime, nuk u miratua propozimi për shkarkim.

**Sami Boroci** propozoi që në vend të znj. Suzan Kika, ish- anëtare e Komisionit komunal të aksionarëve të NPB-së, të caktohet Vesel Makolli.

*Përfaqësuesit e grupeve parlamentare të LDK-së dhe të LVV-së, në shenjë pakënaqësie e lëshuan mbledhjen.*

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që Vesel Makolli të caktohet anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve të NPB-së.**

**Informim mbi punën e aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura".**

**Lidhur me punën e aksionarëve të ndërmarrjes komunale "Hortikultura", të pranishmit i informoi Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.**

**Adrian Berisha** tha se është për t'u falënderuar kjo ndërmarrje për punën e mirë që e bën për qytetin tonë. Lidhur me këtë, ai kërkoi të dijë se çfarë bashkëpunimi ka "Hortikultura" me sektorin privat për shënimin e ditëve të ndryshme botërore të mjedisit, duke përfshirë këtu Ditën Ndërkombëtare të Bicikletave, Ditën Ndërkombëtare të Tokës etj.

**Nol Nushi** ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se ndërtimet e reja që po bëhen nga rruga "B", d.m.th. hapësirat publike ndërmjet banesave janë të mbushura me material ndërtimor, i cili ka mbetur nga ndërtimi i banesave të ndryshme në atë pjesë dhe aty nuk ka kurrfarë rregullimi. A do të kishte pasur mundësi që me iniciuar Komuna vetë një lloj marrëveshje të tillë me qytetarët, ku nëse ata vijnë me projekte të gatshme me i ndihmuar lagjet, me u vetorganizuar edhe me u financuar një pjesë prej Komunës, ndoshta një pjesë edhe prej qytetarëve, apo prej ndonjë ndërmarrje që afaron andej?

**Egzon Azemi** sa i përket çështjes së NPL "Hortikultura", është shumë shqetësuese se si nga kjo ndërmarrje janë vjedhur rreth 40 metra dru, dru të cilat janë dhuruar për familjet e varfëra, për familjet skamnore, ndërsa këtë vit ato janë vjedhur nga zyrtarët e Hortikulturës. Për të gjitha këto keqpërdorime, dikush duhet me dhënë përgjegjësi për këtë çështje. Raste të tilla nuk guxojnë më të ndodhin në Komunën e Prishtinës.

Lidhur me pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, Ismail Kokaj, drejtor, dhe Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, dhanë sqarime të nevojshme.

**Pika e trembëdhjetë  
Pyetje dhe përgjigje**

**Migjen Shala, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për nënkryetarin e Komunës:**

- Në fshatin Bardhosh, te trojet e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, as rruga, as ndriçimi dhe as trotuari nuk janë kryere, përkundër kërkesave që i kam bërë më herët.

- Në fshatin Trudë nëntë familje janë lënë pa kanalizim. Këtë çështje e kamë shprehur më herët dhe ajo nuk po ndodh.
- Po ashtu, në fshatin Trudë, firma që është duke punuar rrugët i ka dëmtuar, edhe pronat private, ju kam njoftuar edhe për këtë. Kanë pasur edhe problem në mes veti pronarët e pronave, duke hedh bërlllok e të gjitha gjërat, d.m.th. drejtoria nuk është duke ndërmarr masa. Kërkoi që këto probleme të tejkalohen.

**Adrian Berisha** ngriti shqetësim, duke thënë se në muajin dhjetor do të fillojë prapë çështja e ajrit të ndotur, e që do të jetë problemi kryesor për qytetarët. Kërkoj të dijë se a kemi mundësi me e shqyrtuar këtë problem, me të cilin do të ballafaqohemi në muajin dhjetor, dhe me krijuar një grup punues, me e parë për disa hapa të vogël që mundemi me i bërë si Kuvend komunal për ndalimin e ajrit të ndotur në komunën tonë.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projekteve, planifikimi është bërë në vitin 2017 dhe tani e kemi vështirë me bërë ndonjë ndryshim. Aty ku mendohet që të bëhet ndonjë intervenim sa i përket rrugëve të reja, jemi të pajtimit që së bashku të dalim në vendin e ngjarjes dhe t'i shohim mundësitë për këtë, ndërsa sa i përket tangimit të pronës, këto janë zakonisht rrugë të përkohshme, dhe besoj se këtu duhet me funksionuar shteti ligjor, shteti i së drejtës. Nëse ka ndonjë konflikt, ne jemi kundër, mos me ardhur në mes të banorëve, sepse nuk është tendenca jonë për një gjë të tillë.

**Agim Gashi**, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Në rrugën "Sylejman Vuçitërna", lagja "Kalabria", është i bllokuar kanalizimi, për shkak se gypat në thellësi janë thyer. Ne si asamblistë jemi angazhuar që ta mobilizojmë Komunën, që të shtrinë ndikimin e vet tek ujësjellësi dhe të ndërhyhet, për shkak se aty rrjedh kanalizimi tash e një muaj, dhe pjesa e lagjes praktikisht është kontaminuar nga ujërat e zeza. Unë e di që është përgjegjësi e ujësjellësit, por Inspeksioni është autoriteti që e detyron cilindo subjekt, pavarësisht se a është i nivelit qendror apo lokal, që ai të veprojë në kuadër të kompetencave që ka.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor, tha se sa i përket kanalizimit, kemi shumë halle, por duhet me qenë të prera kompetencat. Ne e dimë shumë mirë, por edhe banorët e Prishtinës, se qytetarët e Prishtinës paguajnë një shumë të hollash në ujësjellës - KUR "Prishtina", dhe kishte qenë mirë që kompetencat që i ka KUR "Prishtina", në fakt të fillojë të jetë përgjegjës për këtë punë. Për të ndërhyrë në rrjetin e kanalizimit për ndonjë sanim të mundshëm, domosdo duhet pëlqimi nga ana e KUR "Prishtina".

**Leonora Shabani-Bajraktari**, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve:

Faqe 5 nga 8

- Kur do të fillojë rregullimi i kanalizimeve nëpër shkollat fillore, për shkak se të gjitha shkollat fillore në komunën e Prishtinës kanë probleme me ujërat e zeza dhe fëmijët tanë kanë filluar të preken nga infeksione të ndyshme?
- Kur do të fillojë së funksionuari linja e trafikut urban për rrugën "Malush Kosova"?
- Banorët e Lagjes së Muhaxhirëve ka bërë një peticion për rregullimin e atij parkut, por a ka ndërmarrë ndonjë hap Drejtoria sa i përket rregullimit të tij?

**Gëzim Mehmet**, drejtor, tha se dje kam qenë në disa shkolla, në bazë të kërkesës së tyre, dhe kemi konstatuar se bodrumet e disa shkollave janë mbushur me ujë, por problemi nuk qëndron nga shkollat, por qëndron jashtë objektit të shkollave, d.m.th. te kanalizimi në infrastrukturë. Kjo çështje duhet rregulluar së bashku me KUR "Prishtina".

**Ismail Kokaj**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se me ardhjen e autobusëve të rinj, jemi duke e shikuar që sa më mirë me e mbuluar qytetin, dhe për këtë jemi duke e bërë një plan. Në momentin që finalizohet plani, ne do ta prezantojmë.

**Fatime Hajdari** - drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, tha se për parkun te Lagja e Muhaxhirëve, është bërë një projekt ideor i detajuar dhe realizimin e tij do ta bëjmë në vitin e ardhshëm.

#### **Halim Halimi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët e fshatrave të Gollakut kërkojnë që të vihet në qarkullim një linë e trafikut urban: Prishtinë - Keçekollë - Prapashticë - Mutivodë, ngase tash për tash autobusi shkon deri në Keçekollë. Është shumë e nevojshme që autobusi me vazhduar edhe në Prapashticë dhe Mutivodë, deri te kufiri, ngase ka shumë familje të cilat nxënësit i kanë në Prishtinë, të cilëve po iu pamundësohet shkollimi në shkollat e Prishtinës.

**Ismail Kokaj**, drejtor, tha se në momentin që i sistemojmë këta 51 autobusë, ku në bazë të prioriteteve do të ndahen, dhe do të tentojmë me e bërë transportin apo rritjen e autobusëve derisa të mbulojmë komplet rrjetin e Prishtinës, së bashku me trafikun urban.

**Agim Gashi** tha se është kompetencë e Drejtorisë, bazuar në Rregulloren për transportin e udhëtarëve, që linjat ekzistuese kanë mundësi të vazhdoen deri në pikën ku kërkojnë dhe ku janë paraqitur nevojat. Nuk ke nevojë me sjellë propozimin për ndryshim të Rregullores në Asamble, është kompetencë e Drejtorisë. Te linjat ekzistuese, nëse autobusi shkon deri në Keçekollë, lirisht ju mund të merrni vendimin ta vazhdoni linjën deri në Dabishevc ose ku po kërkon diskutuesi, sepse Rregullorja ta mundëson këtë.

#### **Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

1. Pse nuk është duke u bërë menaxhimi adekuat i mbeturinave në tërë qytetin, me theks të veçantë në parkun "Gërmia"?
2. Vendosja e "policëve të shtrirë", pasqyrave dhe shenjave të tjera adekuate të komunikacionit.

- "Policë të shtrirë" apo pengesat për shpejtësi të madhe në rrugët: ish - "Vushtrria" ose "Ahmet Dërguti", nga semaforët e deri prapa varrezave, rruga te stadiumi "Fadil Vokrri" që qon në drejtim të Rrethit, rruga për tek "Arbëria 3", pengesa dhe shenja të këmbësorëve, lagjja tek Hyrja E 31, në Ulpianë, rruga "B" etj.;
  - Pasqyra në shumë kënde të rrezikshme ose me dukshmëri minimale, të cilat kanosin aksidente të ndryshme, si p.sh. në rrugën "Xhavit Ahmeti" (ish-rruga "Bledi"), tek kthesa për parkun "Gërmia", vendosja e disa pasqyrave që ndihmojnë në rregullimin e komunikacionit në lagjet "Arbëria", "Kodra e Trimave", "Velania", "Mati 1", "Xhemail Ibishi" etj..
  - Vendosja e shenjave të trafikut në të gjithë cepat e qytetit, sidomos të paralajmërimit të vendkalimeve, të shkollave, të shtëpive të shëndetit dhe këndeve të lojërave për fëmijë, si dhe paralajmërueset e shpejtësive të lejuara dhe të ndaluara.
3. Vendosja e mbikalimeve në disa pika të favorshme në qytet, sidomos në lagjen "Arbëria" ( tek Rokuzina), e cila lidh lagjen "Arbëria" me qendrën e qytetit ( tek parkingu mbrapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve), pra mbikalimi i cili do e mundësonte tejkalimin e rreziqeve dhe pengesave tek hekurudha, pranë Stacionit të trenave, si dhe rrugën tejet të frekuentuar me vetura dhe me mjete të rënda të transportit në atë pjesë.
  4. Ndriçimi publik, rrugët sekondare, si në lagjet: "Arbëria", "7 shtatori", "Lutfi Veliu", "Plava" dhe "Toni Bler", "Kodra e Trimave" e shumë prej tyre, por me theks të veçantë rrugën "Lutfi Misiqi".
  5. Mbikëqyrja e parkut të Ulpianës, park ky i cili pothuajse është bërë i pashfrytëzueshëm për qytetarët e kësaj lagjeje, ngase ai park është shkatërruar dhe shfrytëzuar (shfrytëzohet) nga narkomanët e ndryshëm, ku çdo ditë qytetarët rastisin në shiringa të drogës etj.
  6. A do të përfundojë rruga "B", nga "Royal Mall" deri tek xhamia?
  7. A do të mbulohet lumi ose kanalizimi në lagjen "Kalabria" dhe kur?
  8. Si do të trajtohen me parkingje dhe trotuare lagjet të cilat janë të mbipolluara, si: Lagjja e Muhaxhirëve", "Mati 1", rruga "B", "Dardania", "Bregu i Diellit", "Velania" etj.?
  9. A do të shtrohet me infrastrukturën e nevojshme rruga "Rrahman Bahtiri" në "Kondrën e Trimave"?
  10. A është ndërmarrë diçka për trajtimin e qenve endacakë në qytet dhe në fshatrat e Prishtinës, ngase përditë kemi raste të cilat janë duke u shfaqur në të gjitha lagjet e qytetit, ku vet jam i njoftuar me disa prej tyre si: në lagjet "Arbëria", "Tophane", "Kodra e Trimave", në Lagjen e Kacallarëve etj.?

**Ismail Kokaj**, drejtor tha se sa i përket vendosjes së policëve ë shtrirë është e pamundur që komplet ta mbulojmë tërë qytetin, mirëpo do të shohim mundësin që ti vendosim edhe në ato rrugë ku kemi kërkesa. Sa i përket vendosjes së shenjave të komunikacionit ato vendosen çdo ditë dhe çdo ditë dëmtohen, ndërprerët kontrata vazhdojmë me lidhjen e kontratës, prapë vendosen shenjat me pasqyre dhe të gjitha ato. Për trajtimin e qenve endacak e kemi problematikë jo vetëm ne si Komunë por komplet si shtet dhe trajtimin e tyre e kemi bërë në bazë të ligjit, por numri i qenve është në rritje e sipër, por si drejtori ne do ta bëjmë atë çka na lejohet.

Egzon Azemi tha se dy apo tre përfaqësues të një grupi të qytetarëve, që janë shumica e tyre pensionistë, janë duke pritur jashtë sallës, andaj kërkoi nga kryesuesi që këtyre qytetarëve t'iu mundësohet hyrja në sallë, meqenëse seanca është e hapur për qytetarët.

Sami Boroci i njoftoi të pranishmit se ata qytetarë sapo i takoi nënkryetari edhe aktualisht janë në takim me nënkryetarin e Komunës.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta

